



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN



UNIVERSITETI I PRIZRENIT
"UKSHIN HOTI"



OJQ EC MA NDRYSHE

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

në mes të

Gjykatës Themelore të Prizrenit

Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti"

dhe

OJQ EC Ma Ndryshe

për

PROGRAMIN E PRAKTIKANTËVE PËR MARRËDHËNIET PUBLIKE NË GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT

I lidhur më 1 Prill 2015, në Prizren

1. Qëllimi

Ky memorandum i bashkëpunimit nënshkruhet për të ndërtuar Programin e Praktikantëve për Marrëdhënie Publike, për t'i ofruar ndihmë Zyrës për Informim Publik të Gjykatës Themelore të Prizrenit me qëllim të forcimit të angazhimit për ngritjen e transparencës dhe komunikimit efektiv të Gjykatës me qytetarët. Ky bashkëpunim synon ndërtimin e burimeve të reja njerëzore në sferën e marrëdhënieve publike brenda Gjykatës Themelore të Prizrenit.

2. Programi i Praktikantëve

Programi i praktikantëve do të jetë i hapur për studentët e Universitetit të Prizrenit (të gjitha drejtimet) të interesuar për të marrë njohuri dhe përvoja të reja dhe kontribuar në punën e Gjykatës Themelore të Prizrenit. Praktikantët do të angazhohen në cikle tre-mujore (me mundësi vazhdimi) përmes thirrjeve të rregullta publike. Në zbatimin e Programit të

praktikantëve do të angazhohen: Gjykata Themelore e Prizrenit – Zyra për Informim Publik, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe organizata jo-qeveritare EC Ma Ndryshe. Pas përfundimit të programit për marrëdhëniet publike, praktikantët do të pajisen me dëshmi përkatëse për pjesëmarrje në këtë program, e cila lëshohet me nënshkrimin e tre palëve (Gjykata Themelore e Prizrenit, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe OJQ EC Ma Ndryshe)

Detajet e Programit janë në shtojcën e këtij Memorandumi, si pjesë integrale e marrëveshjes për bashkëpunim.

3. Partnerët

Gjykata Themelore e Prizrenit - është gjykata e parë ku qytetarët i fillojnë procedurat e tyre gjyqësore. Kjo gjykatë ka jurisdikcion të përgjithshëm, që do të thotë se ajo i gjykon të gjitha çështjet në shkallë të parë përpos nëse me ligj parashihet ndryshe. Gjykata Themelore e Prizrenit ka tri departamente dhe një divizion: Departamenti i Përgjithshëm, Departamenti për të Mitur, Departamenti për Krime të Rënda, dhe Divizioni i Kundërvajtjes. Kjo gjykatë i ka degët e saj në Suharekë dhe Dragash, të cilat i shqyrtojnë rastet që bëjnë pjesë vetëm brenda kompetencave të departamentit të përgjithshëm. Shërbimet administrative dhe mbështetëse të gjykatave janë riorganizuar në pesë zyra: 1. Zyra qendrore për menaxhimin e lëndëve, 2. Zyra për mbështetje juridike, 3. Zyra e financave, 4. Zyra për sigurim dhe logjistikë, dhe 5. Zyra për informim publik.

Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” – ka nisur punën në vitin 2010 pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për themelimin. Selia e Universiteti është në Prizren, njëri nga qytetet më të lashta të Kosovës. UPZ është Universiteti i dytë publik në Kosovë. Në vitin 2010 numri i studentëve ishte afër 1700, ndërsa tani, në vitin 2014, numri i studentëve është rreth 8000 studentë. Universiteti është i akredituar nga viti 2010. Për herë të fundit i është nënshtruar procesit të akreditimit vitin e kaluar dhe është riakredituar. Momentalisht Universiteti ofron studime në ciklin Bachelor dhe Master.

OJQ EC Ma Ndryshe – është themeluar në vitin 2006 si reagim ndaj veprimeve degraduese në strukturën urbane të qytetit të Prizrenit. Organizata angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

4. Veprimet e përbashkëta

Gjykata Themelore e Prizrenit, Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” dhe OJQ EC Ma Ndryshe zotohen, përmes këtij Memorandumi, zotohen se bashkërisht do të realizojnë Programin e Praktikantëve për Marrëdhëniet Publike. Realizimi i këtij programi nënkupton veprimet e mëposhtme:

- Hartimi i Programit të detajuar të punës praktike,
- Përcaktimi i kritereve për t’u pranuar në Program,
- Shpallja e thirrjes publike për pjesëmarrje në Program (në baza të rregullta),
- Themelimi i Komisionit të përbashkët vlerësues/intervistues,
- Vlerësimi i kandidatëve dhe shpallja e listës së fituesve,
- Vlerësimi i punës së praktikantëve gjatë periudhës së Programit,


- Pasurimi i Programit në bazë të vlerësimeve të ecurisë së përgjithshme
- Veprime të tjera në interes të realizimit të suksesshëm të Programit.

5. Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Memorandumi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të tre partnerët, ndërsa ndërprerja e tij mund të realizohet me vullnet të secilës palë për të përfunduar partneritetin dhe zotimet e dhëna përmes këtij dokumenti.

Palët nënshkruese

Gjykata Themelore e
Prizrenit




Ymer Hoxha, Kryetar

Datë

1 / Prill / 2015

Universiteti i Prizrenit
"Ukshin Hoti"




Ramë Vataj, Rektor

Datë

1 / Prill / 2015

OJQ EC Ma Ndryshe



Hajrulla Çeku, Drejtor

Datë

1 / Prill / 2015